



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



ZKA

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË K.R.U. "HIDRODRINI" SH.A PËR VITIN 2024

Prishtinë, qershor 2025

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Pasqyrat financiare vjetore të audituara

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të K.R.U. "Hidrodrini" sh.a për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2024, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kundërt për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të K.R.U. "Hidrodrini" sh.a (K.R.U. "Hidrodrini" sh.a), të cilat përmbajnë pasqyrën e pozitës financiare për vitin 2024, pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e rrjedhës së parasë së gatshme, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet, shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme kontabël, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2024.

Sipas opinionit tonë, për shkak të efekteve të çështjes/ve së përshkruar në paragrafin "Baza për Opinion të Kundërt", Pasqyrat Financiare të bashkangjitura nuk paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të pozitës financiare të K.R.U. "Hidrodrini" sh.a deri me 31 dhjetor 2024, të performancës së saj financiare, si dhe rrjedhës së parasë së gatshme për vitin 2024, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për Opinion të kundërt

- A1 Ndërmarrja kishte prezantuar pasuri në vlerë 39,212,482€, ndërsa sipas regjistrit dhe shënimeve kontabël vlera e tyre ishte 38,147,782€, duke rezultuar në mospërputhje prej 1,064,700€. Po ashtu trajtimi i pasurive nuk ishte bërë sipas standardeve dhe politikave të ndërmarrjes. Impianti i ujërave të zeza në vlerë prej 25,828,816€ është në përdorim që nga 2022, por figuron si investim në vijim dhe nuk është aplikuar zhvlerësim për të. Tutje, pasuri në vlerë prej 1,480,316€ janë prezantuar si në përdorim, por në regjister figurojnë si investime në vijim. Gjithashtu, për pasuritë me vlerë 23,669,426€, është aplikuar normë zhvlerësimi 5% në vend të normës 20%.
- A2 Ndërmarrja nuk ka ofruar dëshmi për 45 pasuri në përdorim me vlerë 6,357,590€, si dhe për investime në vijim në vlerë 25,828,816€.
- B1 Ndërmarrja nuk ka bërë rivlerësimin e pasurive fikse që nga viti 2005. Në regjister figurojnë 1,961 pasuri, të cilat kanë vlerë neto në libra kontabël zero dhe një kosto historike totale prej 3,276,729€ dhe në rast të rivlerësimit vlera e tyre kontabël mund të ndryshojë materialisht nga ajo që është prezantuar në fund të periudhës raportuese.
- A3 Shuma e rezervës së rivlerësimit e prezantuar në pasqyrat financiare është 21,744,554€, e cila rrjedh nga rivlerësimi i asetëve në vitin 2005. Kjo shumë nuk është korrigjuar rregullisht përmes zhvlerësimit të pjesës së rritur të vlerës, ndërsa ndërmarrja nuk posedon regjister të veçantë për këto asetë, duke krijuar pasiguri mbi saktësinë dhe bazën kontabël të regjistrimeve.

- A4 Investimet për projektin “Ujë dhe kanalizim në zonat rurale, faza VI” në vlerë 2,206,210€, të financuara nga Ministria e Ekonomisë dhe Qeveria Zvicerane përmes CDI, nuk ishin regjistruar ende në regjistrin e aseteve të ndërmarrjes.
- B2 Llogaritë e arkëtueshme të prezantuara në pasqyra financiare, krahasuar me shënimet analitike, kishin rezultuar me një diferencë për 3,285,733€. Për më tepër, në (3) raste të llogarive të arkëtueshme të prezantuara në pasqyra financiare në vlerë 6,922€ kanë rezultuar me mbivleresim të llogarive të arkëtueshme.
- B3 Arkëtimet në shumën prej 196,494€, nuk i janë zbritur konsumatorëve përkatës për obligimet e paguara ndaj ndërmarrjes, por këto mjete ishin regjistruar me përshkrimin “Konsumatorë i paidentifikuar”.
- A5 Pasuritë tjera afatshkurtra në vlerë prej 1,481,504€ nuk pasqyrojnë saktë gjendjen e tyre. Brenda këtij zëri janë përfshirë TVSH-ja e zbritshme në vlerë 1,167,266€, ndërsa sipas të dhënave të ATK-së rezulton të jetë 343,182€. Tutje, parapagimet për tatimin në fitim ishin 43,192€, ndërsa sipas ATK-së 21,033€. Ndërsa parapagimet ndaj furnitorëve në vlerë 240,445€ nuk përfaqësonin realisht parapagime. Gjithashtu mungonin dëshmitë për akontacionet në vlerë 5,497€.
- A6 Ndërmarrja nuk posedon dëshmi përkatëse për 13,882 artikuj në vlerë 156,058€, të pranuar si donacion. Po ashtu, nuk ka harmonizuar regjistrin e stoqeve me raportin e inventarizimit.
- B4 Të hyrat e shtyra nga grantet nuk pasqyrojnë gjendjen e tyre të saktë, pasi që ekziston një mospërputhje në vlerë prej 1,841,868€ ndërmjet shumës së prezantuar në pasqyrat financiare dhe listës së aseteve të financuara nga grantet. Po ashtu, mungojnë dëshmi mbështetëse që vërtetojnë se asetet e përfshira në këtë shumë janë të financuara nga grantet. Ndërkohë, vlera e të hyrave nga grantet në pasqyrën e të ardhurave, krahasuar me zhvlerësimin e aseteve të financuara nga grantet tregon një diferencë prej 388,452€.
- B5 Ndërmarrja kishte prezantuar llogari të pagueshme në vlerë 116,024€, ndërsa sipas të dhënave kontabël detyrimet ishin 222,207€ dhe parapagimet 383,539€. Gjatë vitit 2024 nuk janë kryer harmonizime me furnitorët. Në katër (4) raste konfirmimet ishin 0€, ndërsa në kontabilitet figuronin parapagime prej 132,264€. Në pesë (5) raste të tjera, ndërmarrja kishte evidentuar obligime në vlerë prej 209,667€, ndërsa sipas letër konfirmimeve vlera e obligimit ishte 0. Në një (1) rast, ndërmarrja kishte regjistruar parapagim 54,051€, ndërsa sipas konfirmimit të furnitorit rezulton të jete obligim i papaguar 1,700€.
- B6 Ndërmarrja kishte prezantuar detyrime të tjera afatshkurtra në vlerë prej 2,657,699€, duke përfshirë 2,630,543€ për TVSh dhe 27,156€ detyrime për tatime e kontribute në paga. Megjithatë, sipas të dhënave nga ATK, detyrimi për TVSh rezulton të jetë zero, ndërsa detyrimi për tatime dhe kontribute është 38,183€.
- A7 Ndërmarrja kishte hartuar pasqyrën e rrjedhës së parasë së gatshme, por rrjedha neto nga aktivitetet operative ishte mbivlerësuar për 309,619€. Po ashtu, pagesat investuese për pronën, pajisjet dhe impiantet ishin mbivlerësuar për 487,725€, ndërsa për pagesa të tjera investuese prej 85,230€ nuk ka ofruar dëshmi.
- B7 Në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare mungonin informacione të rëndësishme. Ndërmarrja nuk ka shpalosur informacione për përbërjen e investimeve në vijim, politikën kontabël për inventarët, korrigjimet në ekuitet, të hyrat nga grantet dhe detyrimet kontigjente.

- B8 Ndërrmarja nuk kishte provizionuar llogaritë e arkëtueshme, prej saldosh bruto 18,937,668€, 97% e tyre ishin të arkëtueshme me të vjetra se 1 vit prandaj ne nuk kemi mundur të marrim siguri se vlera bartëse neto prej 12,491,369€ e llogarive të arkëtueshme tregtare e prezantuar në pasqyra financiare është e saktë.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë të pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit të përgjithshëm për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10 dhe SNISA 130, si dhe me kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të Ndërmarrjeve Publike dhe Kodin e Etikës të ZKA-së, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion, transaksionet e kryera të K.R.U. "Hidrodrini" sh.a kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- A8 Ndërmarrja ofron shërbime për 59,575 konsumatorë, por kishte lidhur kontrata vetëm me 7,716 prej tyre apo vetëm rreth 13%. Gjithashtu, 186 konsumatorë figurojnë pa të dhëna identifikuese të cilët rezultojnë në parapagim në shumën 57,460€.
- A9 Gjatë vitit 2024, ndërmarrja ka realizuar shpenzime në vlerë 31,088€ për telefoninë mobile dhe 1,740€ për ndarje kthinash në zyre dhe laborator, pa marrëveshje kontraktuale. Në një rast tjetër, furnizimi me kimikate për ITUN ishte nënvlerësuar për 3,476.56€.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10 dhe SNISA 130, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të Ndërmarrjeve Publike, Kodin e Etikës të ZKA-së, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Informacione të tjera të ndryshme nga pasqyrat financiare dhe raporti i auditorit mbi to

Menaxhmenti është përgjegjës për informacionet e tjera. Informacionet e tjera përfshijnë informacionet në raportin e menaxhmentit dhe deklaratën e qeverisjes korporative, por këto informacione nuk përfshijnë pasqyrat financiare dhe raportin tonë të auditorit mbi këto pasqyra.

Opinionin ynë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim ndonjë lloj konkluzioni që jep siguri në lidhje me këto informacione.

Në lidhje me auditimin e pasqyrave financiare, ne kemi përgjegjësinë të lexojmë informacionet e tjera dhe të vlerësojmë nëse këto informacione kanë inkoherenca materiale me pasqyrat financiare apo me njohjen që ne kemi marrë gjatë auditimit ose përndryshe, nëse duket se janë me anomali materiale.

Ne kemi marrë parasysh nëse informacionet në raportin për menaxhmentin janë në përputhje me informacionet në pasqyrat financiare dhe deklarata e qeverisjes korporative përfshinë shpalosjet e kërkuara me nenet 7 dhe 10 të ligjit 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim.

Nëse, bazuar në punën e kryer, arrijmë në përfundimin se në këto informacione ka një anomali materiale, atëherë ne duhet të raportojmë për këtë fakt. Siç përshkruhet në seksionin e bazës për opinionin e kundërt:

- 1 Ndërmarrja nuk ka hartuar raportin vjetor për vitin 2024 për shkak të mungesës së Bordit të Drejtorëve, i cili sipas nenit 31 të Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike është organi përgjegjës për miratimin dhe dorëzimin e raportit vjetor të aksionari.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF). Po ashtu, menaxhmenti është përgjegjës për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa keqdeklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë gjithashtu zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime), Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike (me plotësime dhe ndryshime), Ligjit 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim.

Bordi i Drejtorëve është përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të K.R.U. "Hidrodrini" sh.a.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i K.R.U. "Hidrodrini" sh.a është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të K.R.U. "Hidrodrini" sh.a në përputhje me Ligjin për Ndërmarrjet Publike, si dhe të gjitha ligjet, rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.²

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të marrim siguri të arsyeshme se Pasqyrat Financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të nxjerrim një raport të auditimit që përfshinë opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është niveli i lartë sigurie, por nuk garanton se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keqdeklarim material që mund të ekzistojë. Keqdeklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, me arsye pritet që të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra në bazë të këtyre Pasqyrave Financiare.

Objekivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të K.R.U. "Hidrodrini" sh.a me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare. Si pjesë e auditimit, në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-t, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keqdeklarimit material të Pasqyrave Financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit; hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit konform atyre rreziqeve, si dhe sigurojmë dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të duhura për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i moszbulimit të një keqdeklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për keqdeklarimin që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulimin, falsifikimin, lëshime të qëllimshme, keqpërfaqësime apo anashkalimin e kontrollit të brendshëm.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme në rrethanat, por jo me qëllim të shprehjes së opinionit për efikasitet të kontrollit të brendshëm të K.R.U. "Hidrodrini" sh.a.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të përdorura kontabël dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet përkatëse të bëra nga menaxhmenti.
- Nxjerrim një përfundim nëse baza e vijimësisë së kontabilitetit është e përshtatshme për përdorim nga menaxhmenti, bazuar në provat e siguruara të auditimit, nëse ekziston pasiguria materiale në lidhje me ngjarje apo kushte që mund të hedhin dyshime të rëndësishme në aftësinë e K.R.U. "Hidrodrini" sh.a, për të vazhduar sipas parimit të vijimësisë. Nëse konkludojmë se ekziston një pasiguri materiale, nga ne kërkohet që të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për shpalosjet përkatëse në Pasqyrat Financiare ose, nëse zbulimet e tilla janë të papërshtatshme ta modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona bazohen në provat e auditimit të marra deri në datën e raportit tonë të auditimit. Sidoqoftë, ngjarjet apo kushtet e ardhshme mund të bëjnë që NP-ja të pushojë së vazhduari sipas parimit të vijimësisë.

- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e Pasqyrave Financiare, përfshirë edhe shpalosjet, për t'u siguruar se Pasqyrat Financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si sensitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Ky raport ka rezultuar me 18 rekomandime, prej tyre 10 janë rekomandime të reja dhe tetë (8) të përsëritura.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 3.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja A1 - Dobësi në regjistrimin e pasurive

Gjetja

Sipas SNK 1, paragrafi 15, Pasqyrat financiare duhet të pasqyrojnë drejtë pozicionin financiar, performancën financiare dhe fluksin e mjeteve monetare të një njësie ekonomike. Paraqitja e drejtë kërkon një përfaqësim të besueshëm të efekteve të transaksioneve, ngjarjeve dhe kushteve të tjera në përputhje me përkufizimet dhe kriteret e njohjes për pasuritë, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet të përcaktuara në Kuadrin konceptual për raportimin financiar. Ndërsa, paragrafi 55, amortizimi fillon kur aktivi është i disponueshëm për përdorim, që do të thotë, kur ai është vendosur në kushtet dhe vendin e nevojshëm për t'u përdorur në mënyrën e synuar nga drejtimi. Po ashtu, paragrafi 60, metoda e amortizimit e përdorur pasqyron modelin me të cilin përfitimet ekonomike të ardhshme të aktivës pritet të konsumohen prej njësisë ekonomike. Tutje, SNK 8 "Politikat Kontabël", përcaktojnë se një njësi ekonomike zgjedh dhe zbaton politikat e saj me qëndrueshmëri për transaksione, ngjarje dhe kushte të tjera të ngjashme.

Në pasqyrën e pozicionit financiar ndërmarrja kishte prezantuar pasuri të prekshme dhe të paprekshme në vlerë 39,212,482€, ndërsa sipas shënimeve kontabël, vlera e pasurive ishte 38,147,782€, duke rezultuar në mospërputhje në total vlerë prej 1,064,700€.

Vlenë të theksohet se nga totali i pasurive të prezantuar vlera prej 26,213,266€ janë pasuri të regjistruara si investime në vijim, ndërsa sipas shënimeve kontabël janë 27,322,803€ si investime në vijim, duke rezultuar në mos përputhje në shumë prej 1,109,537€.

Përveç mospërputhjeve të lartcekura, ne kemi vërejtur se trajtimi i pasurive nuk ishte bërë në përputhje me standardet dhe politikat e përcaktuara.

Dobësitë e identifikuar janë si në vijim:

- Impianti i ujërave të zeza, në vlerë prej 25,828,816€, vazhdon të jetë i regjistruar si investim në vijim, megjithëse kjo pasuri është në përdorim që nga viti 2022 dhe nuk është aplikuar zhvlerësimi për të.
- Pasuritë në vlerë prej 1,480,316€ ishin prezantuar si pasuri në përdorim në pasqyrat financiare, ndërkohë që në regjistër figurojnë si investime në vijim.
- Për pasuritë me kosto historike në vlerë prej 23,559,494€ të cilat i takojnë kategorisë rrjeti i ujësjellësit, ndërmarrja ka aplikuar normën e zhvlerësimit prej 5%, ndërsa sipas politikës së ndërmarrjes, norma e zhvlerësimit për këtë kategori është 20%. Po ashtu, për pasuritë të cilat i takojnë kategorisë makineritë dhe pajisjet, me kosto historike prej 109,932€, është aplikuar norma 5% në vend të normës së përcaktuar 20%.

Kjo situatë është pasojë e mungesës së dëshmive lidhur me impiantin si dhe të regjistrimeve në vitet e mëparshme dhe mungesës së një politike të qartë dhe të mirë përcaktuar për trajtimin dhe zhvlerësimin e aseteve.

Ndikimi

Mospërputhja në vlerën e pasurive të prekshme dhe të paprekshme, dhe përdorimi i normave jo adekuate të zhvlerësimit, përveç që tregon dobësi në menaxhimin e aseteve, ndikon në prezantimin e pasaktë të tyre në pasqyrat financiare, duke ulur besueshmërinë e informacionit financiar të ndërmarrjes.

Rekomandimi A1

Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë kritere të qarta lidhur me trajtimin e pasurive në shfrytëzim dhe të aplikohen normat e duhura të zhvlerësimit, të cilat pasqyrojnë saktë konsumimin e përfitimeve ekonomike.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A2 - Mungesa e dëshmive mbështetëse për pasuritë fikse dhe investimet në vijim

Gjetja

Sipas SNK 16 paragrafi 7, përcakton se kostoja e një aktivi afatgjatë material (toka, ndërtesa, makineri dhe pajisje) do të njihet si aktiv nëse dhe vetëm nëse: (a) Është e mundshme që përfitimet ekonomike të ardhshme që i atribuohen atij aktivi do të rrjedhin te njësi ekonomike; dhe (b) Kostoja e aktivës mund të matet me besueshmëri.

Ndërmarrja nuk ka arritur të ofrojë dëshmi përkatëse për 45 pasuri në vlerë totale prej 6,357,590€, të cilat përfshijnë asete në përdorim si: toka, ndërtesa rrjete ujësjellësi dhe pajisje. Po ashtu, nuk janë ofruar dëshmi mbështetëse as për investimet në vijim, të regjistruara në vlerë 25,828,816€.

Mungesa e dëshmive ishte si rezultat mos bartjes së informacionit dhe dokumentacionit përkatës nga menaxhmentet ndër vite si dhe mangësive në arkivimin e dokumentacionit përkatës.

Ndikimi

Mungesa e dokumenteve mbështetëse pamundëson vërtetimin dhe vlerësimin nëse zëri pasuritë e prekshme dhe investimet në vijim është prezantuar drejtë në pasqyrat financiare vjetore.

Rekomandimi A2

Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë dëshmitë që vërtetojnë vlerën e plotë të pasurive dhe investimeve në vijim të regjistruara në regjistrin kontabël, të cilat rrjedhimisht prezantohen edhe në pasqyrat financiare vjetore

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B1 - Mos rivlerësimi i pasurive të ndërmarrjes

Gjetja

Sipas SNK 16, paragrafi 31, Pasuritë afatgjata materiale - rivlerësimet duhet të bëhen në mënyrë të rregullt dhe të mjaftueshme, që të sigurohet se vlera kontabël (neto) e pasurisë nuk ndryshon materialisht nga ajo që do të përcaktohej, nëse do të përdorej vlera e drejtë në fund të periudhës raportuese.

Procesi i vlerësimit të pasurive është realizuar për herë të fundit nga ndërmarrja në vitin 2005. Aktualisht, në regjister figurojnë 1,961 pasuri, të cilat kanë vlerë neto në libra kontabël zero dhe një kosto historike totale prej 3,276,729€. Sipas përshkrimit të pasurive, ato përfshijnë: toka, objekte dhe struktura ndërtimore, makineri dhe automjete, si dhe pajisje për zyre dhe kompjuterike. Këto pasuri janë ende aktive dhe për to nuk ishte bërë rivlerësimi dhe rishikimi i jetëgjatësisë së tyre, ashtu siç nuk është bërë edhe për pasuritë e tjera.

Mos rivlerësimi i pasurive kishte ndodhur pasi menaxhmenti i ndërmarrjes i kishte konsideruar pasuritë e ujësjellësit si specifike dhe për këtë arsye, kishte vlerësuar se zbatimi i rivlerësimit në praktikë ishte i vështirë.

Ndikimi

Fakti që një numër i pasurive që është në përdorim dhe ka vlerën në libra zero në rast të një rivlerësimi vlera e këtyre pasurive mund të jetë materialisht e ndryshme nga vlera e prezantuar në Pasqyra Financiare Vjetore (PFV). Këto mangësi ndikojnë në prezantim jo të drejtë dhe të vërtetë të gjendjes së pasurive në PFV.

Rekomandimi B1

Bordi i Drejtorëve të sigurojë që në përputhje me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit, të bëhet rivlerësimi i pasurive të ndërmarrjes, me qëllim të prezantimit të vlerës së drejtë të tyre në Pasqyrat Financiare Vjetore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A3 - Prezantimi jo i saktë i Rezervës së Rivlerësimit**Gjetja**

SNK 16 - Pasuritë afatgjata materiale, paragrafi 39, përcakton që, nëse vlera kontabël (neto) e një pasurie rritet si rezultat i një rivlerësimi, rritja do të njihet në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse dhe akumulohet tek kapitalet e veta me titullin tepricë rivlerësimi. Megjithatë, rritja njihet në fitim ose humbje për atë që kjo mbulon uljen e rivlerësimit të të njëjtit pasuri të njohur më parë në fitim ose humbje. Po ashtu - paragrafi 40, përcakton, nëse vlera kontabël (neto) e një pasurie ullet si rezultat i një rivlerësimi, ulja njihet në fitim ose humbje. Megjithatë, ulja do të njihet në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për atë që kjo mbulon çdo tepricë kreditore ekzistuese në tepricën e rivlerësimit në lidhje me atë pasuri. Rënia që njihet në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse, zvogëlon shumën e akumuluar në kapital në zërin, tepricë nga rivlerësimi.

Shuma e rezervës së rivlerësimit e prezantuar në pasqyrat financiare është 21,744,554€, e cila rrjedh si rezultat i rritjes së vlerës së aktiveve pas rivlerësimit të realizuar në vitin 2005. Megjithatë, kjo shumë nuk është korigjuar në baza të rregullta përmes zhvlerësimit që i takon pjesës së rritur të vlerës së asetëve si rezultat i rivlerësimit. Gjithashtu, ndërmarrja nuk posedon një regjistër të asetëve si rezultat i këtij rivlerësimi. Mungesa e këtij regjistri krijon pasiguri në lidhje me saktësinë dhe bazën kontabël të regjistrimeve përkatëse.

Mos korigjimi i rezervës së rivlerësimit që nga rivlerësimi i fundit, ka ndodhur në mungesë të një regjistri të asetëve pas rivlerësimit dhe të analizës të trajtimit të pjesës së rezervës së rivlerësimit sipas kërkesave të standardeve.

Ndikimi

Mos korigjimi i rezervës së rivlerësimit për zhvlerësimin e akumuluar ndër vite ka ndikuar në prezantim jo të saktë të pasqyrave financiare.

Rekomandimi A3

Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë korigjimin e rezervës së rivlerësimit sipas kërkesave të standardeve, në mënyrë që pasqyrat financiare të prezantojnë pamje të drejtë dhe të vërtetë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**Çështja A4 - Mos regjistrim i pasurive të financuara nga donatorët****Gjetja**

Bazuar në Marrëveshjen e Mirëkuptimit mes Ministrisë së Ekonomisë dhe KRU Hidrodrini, për kalimin e pronësisë së investimeve kapitale të "Projektit për ujë dhe kanalizim në zonat rurale të Kosovës, faza VI", neni 3 përcakton se përfituesi merr pronësinë dhe menaxhimin e plotë të pasurisë së përfshirë në objektin e marrëveshjes, pa asnjë kufizim.

Më datë 13.04.2023, KRU Hidrodrini dhe Ministria e Ekonomisë kishin lidhur një marrëveshje mirëkuptimi për kalimin e pronësisë së investimeve kapitale që ndërlidhen me “Projektin për ujë dhe kanalizim në zonat rurale të Kosovës, faza VI”, në vlerë prej 2,206,210€. Këto investime ishin realizuar në fshatrat e komunave të Pejës, Klinës dhe Deçanit. Ky projekt ishte financuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Qeveria Zvicerane përmes programit CDI. Megjithatë, këto asete nuk ishin regjistruar ende në regjistrin e aseteve të ndërmarrjes.

Kjo kishte ndodhur për shkak se, me rastin e nënshkrimit të marrëveshjes, nuk ishte bërë pranimi i dëshmive përkatëse, si: faturat apo raportet e realizimit të punëve.

Ndikimi Mos regjistrimi i këtyre pasurive ndikon në nënvlerësimin e pasurisë së ndërmarrjes dhe të hyrave të shtyra nga grantet. Si rrjedhojë, kjo ndikon në prezantim jo të saktë të pasqyrave financiare.

Rekomandimi A4 Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë që fillimisht të bëjë një vlerësim të gjendjes së pasurive të pranuar nga Ministria e Ekonomisë, për të përcaktuar nëse ato janë të gatshme për përdorim apo të papërfunduara. Në bazë të këtij vlerësimi, asetet duhet të regjistrohen si pasuri në përdorim ose si investime në vijim.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B2 - Mos prezantim i saktë i llogarive të arkëtueshme

Gjetja Sipas SNK 1, paragrafi 15, Pasqyrat financiare duhet të pasqyrojnë drejtë pozicionin financiar, performancën financiare dhe fluksin e mjeteve monetare të një njësie ekonomike. Paraqitja e drejtë kërkon një përfaqësim të besueshëm të efekteve të transaksioneve, ngjarjeve dhe kushteve të tjera në përputhje me përkufizimet dhe kriteret e njohjes për pasuritë, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet të përcaktuara në Kuadrin konceptual për raportimin financiar. Po ashtu, Ligji Nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, neni 12, kërkohet që Shoqëritë tregtare të verifikojnë të paktën një herë në vit, ekzistencën dhe vlerësimin e pasurive, detyrimeve dhe kapitalit nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dëshmive të tyre mbështetëse, i cili duhet të barazohet me librat kontabël.

Në pasqyrën e pozicionit financiar ndërmarrja kishte prezantuar "Llogari të arkëtueshme tregtare dhe të tjera", në shumën 12,787,284€ për të cilat janë identifikuar mangësitë si në vijim:

- Në pasqyrat financiare, llogaritë e arkëtueshme në vlerë bruto janë raportuar në shumën 18,937,668€, ndërsa sipas listës analitike të llogarive të arkëtueshme, vlera e tyre është 15,651,935€, duke rezultuar në një diferencë në vlerë prej 3,285,733€.
- Po ashtu, kemi identifikuar se ndërmarrja nuk kishte bërë harmonizimin e gjendjeve kontabël të llogarive të arkëtueshme me dëshmitë e tyre mbështetëse. Për më tepër, tre (3) raste të llogarive të arkëtueshme të prezantuara në pasqyra financiare në vlerë 6,922€ kanë rezultuar me mbivlerësim të llogarive të arkëtueshme.
- Përveç kësaj, në kuadër të llogarive të arkëtueshme janë përfshirë edhe "të arkëtueshme të tjera" në vlerë prej 295,915€, nga të cilat 146,038€ nuk përfaqësojnë realisht të arkëtueshme, por janë regjistrime në një konto të përkohshme kalimtare, e cila ende nuk është mbyllur.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mos shqyrtimit të duhur të llogarive të arkëtueshme nga menaxhmenti si dhe mungesës së harmonizimeve periodike para aprovimit të PFV.

Ndikimi

Mos harmonizimi i llogarive të arkëtueshme përveç që është një dobësi e kontrollit të brendshëm ndikon në prezantim jo të saktë të tyre në pasqyrave financiare, duke zbehur besueshmërinë e raportimit financiar.

Rekomandimi B2

Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë se gjatë hartimit të pasqyrave financiare janë harmonizuar të dhënat kontabël me zërat e pasqyrave financiare si dhe janë marrë të gjitha veprimet e nevojshme për harmonizimin vjetor të gjendjes së llogarive të arkëtueshme dhe klientëve të saj në baza periodike, në mënyrë që të konfirmohet vlera saktë e llogarive të arkëtueshme.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B3 - Mungesa e identifikimit të pagesave nga konsumatorët e paidentifikuar

Gjetja

Sipas SNK 1, paragrafi 15, Pasqyrat financiare duhet të pasqyrojnë drejtë pozicionin financiar, performancën financiare dhe fluksin e mjeteve monetare të një njësie ekonomike. Paraqitja e drejtë kërkon një përfaqësim të besueshëm të efekteve të transaksioneve, ngjarjeve dhe kushteve të tjera në përputhje me përkufizimet dhe kriteret e njohjes për pasuritë, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet të përcaktuara në kuadrin konceptual për raportimin financiar.

Ndërmarrja kishte arkëtuar mjete financiare në shumë prej 196,494€, të cilat i kishte regjistruar në kuadër të llogarive të arkëtueshme me përshkrimin "Konsumatorë të paidentifikuar". Këto mjete nuk i janë zbritur konsumatorëve përkatës për obligimet e paguara ndaj ndërmarrjes.

Llogaria me mjete të paidentifikuara është problem i bartur ndër vite, si pasojë e vështirësive në identifikimin e konsumatorëve të cilët kanë kryer pagesat përmes llogarive bankare për shkak të përshkrimit jo identifikues.

Ndikimi

Mos identifikimi i saktë i pagesave të klientëve rrit rrezikun që klientët të ngarkohen padrejtësisht me obligime të cilat i kanë paguar.

Rekomandimi B3

Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë që janë marrë veprimet e duhura për të identifikuar konsumatorët të cilët i kanë kryer pagesat dhe potencialisht sete bëjnë harmonizimet me klientët e identifikuar.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**Çështja A5 - Mos prezantim i saktë i pasurive tjera afatshkurtra****Gjetja**

Paragrafi 4.4 i Kornizës Konceptuale specifikon se një pasuri njihet në pasqyrën e pozicionit financiar kur është e mundur që përfitimet ekonomike të ardhshme do të hyjnë në njësinë ekonomike dhe kostoja ose vlera e pasurisë mund të matet me besueshmëri.

Në pasqyrën e pozicionit financiar ndërmarrja kishte prezantuar Pasuritë tjera afatshkurtra, në shumën 1,481,504€ për të cilat janë identifikuar mangësitë si në vijim:

- TVSH-ja e zbritshme në pasqyrat financiare ishte prezantuar në shumën 1,167,266€, ndërsa sipas të dhënave nga "Gjendja e përgjithshme e deklarimeve dhe transaksioneve tjera të tatimpaguesit" nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK), kjo shumë rezulton të jetë vetëm 343,182€.
- Parapagimet ndaj furnitorëve në vlerë prej 240,445€ nuk përfaqësojnë realisht parapagime për furnitorë. Nga kjo shumë, 95,729€ kanë të bëjnë me TVSh të pagueshme që nga viti 2015. Për më tepër, në këtë llogari janë regjistruar edhe 2,676 konsumatorë në vlerë 141,582€ të cilët kishin lidhur kontrata me ndërmarrjen për ri programim të borxheve megjithatë të njëjtit figurojnë edhe në listën e llogarive të arkëtueshme tregtare.
- Ndërmarrja kishte raportuar akontacione në shumë 7,398€, mirëpo nuk posedon dëshmi për akontacione në shumë 5,497€.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mos harmonizimeve me ATK-në dhe të gabimeve që kishin ndodhur gjatë regjistrimeve të transaksioneve nga zyrtarët e ndërmarrjes dhe të cilat kanë reflektuar në saldon përfundimtare.

Ndikimi

Mangësitë e identifikuar ndikojnë në besueshmërinë e informacionit financiar dhe prezantim jo të saktë të pasurive në pasqyrat financiare.

Rekomandimi A5

Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë, që procesi i regjistrimit të transaksioneve që ndërlidhën me pasuritë tjera afatshkurtra, të bëhet në mënyrën e duhur për të siguruar prezantim të saktë të tyre në pasqyrat financiare.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A6 - Mungesa e dëshmive mbështetëse dhe mos-harmonizimi i regjistrave të stoqeve me raportin e inventarizimit**Gjetja**

Sipas SNK 1, paragrafi 15, Pasqyrat financiare duhet të pasqyrojnë drejtë pozicionin financiar, performancën financiare dhe fluksin e mjeteve monetare të një njësie ekonomike. Paraqitja e drejtë kërkon një përfaqësim të besueshëm të efekteve të transaksioneve, ngjarjeve dhe kushteve të tjera në përputhje me përkufizimet dhe kriteret e njohjes për pasuritë, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet të përcaktuara në Kuadrin konceptual për raportimin financiar. Për më tepër, sipas Ligji Nr.06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, neni 12, kërkohet që Shoqëritë tregtare, verifikojnë të paktën një (1) herë në vit, ekzistencën dhe vlerësimin e pasurive, detyrimeve dhe kapitalit nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dëshmive të tyre mbështetëse nëpërmjet procesit të inventarizimit.

Në pasqyrën e pozicionit financiar ndërmarrja kishte prezantuar stoqe, në shumën 702,875€ për të cilat janë identifikuar mangësitë si në vijim:

Ndërmarrja nuk posedon dëshmi përkatëse për pranimin e 13,882 artikujve në vlerë 156,058€, të cilat ishin pranuar si donacion dhe të njëjtat figurojnë ende në stok.

Gjithashtu, ndërmarrja nuk ka kryer harmonizimin e regjistrit të stoqeve me raportin e komisionit të inventarizimit. Ne kemi identifikuar mospërputhje në mes të raportit të komisionit të inventarizimit dhe të dhënave kontabël për stoqet në aspektin sasior. Për 84 artikuj, sipas regjistrit kontabël, sasia e evidentuar është 144,587 njësi më shumë sesa në raportin e komisionit të inventarizimit. Ndërsa për 133 artikuj të tjerë, sasia në listën e komisionit të inventarizimit është 10,910 njësi më shumë sesa në regjistrin kontabël

Mungesa e dëshmive mbështetëse për donacionet është rezultat i mos arkivimit të dokumentacionit dhe kohës së gjatë që ka kaluar nga pranimi i tyre. Mos harmonizimi i regjistrave është si rrjedhojë e mungesës së veprimeve konkrete nga zyrtarët përgjegjës për përditësimin dhe harmonizimin e të dhënave kontabël me ato të inventarizimit.

Ndikimi

Mangësitë e identifikuar më lartë përveç që zvogëlojnë sigurinë e ekzistencës së tyre, rritë mundësinë e keqpërdorimit humbjes apo tjetërsimit të tyre dhe ndikojnë në prezantim jo saktë të pasqyrave vjetore financiare.

Rekomandimi A6

Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë dëshmitë përkatëse për të gjitha donacionet e pranuar. Po ashtu, të sigurojë që procesi i inventarizimit të bëhet në mënyrë të rregullt para dorëzimit të pasqyrave financiare, në mënyrë që rezultatet e regjistrimeve të fund vitit të harmonizohen me regjistrat kontabël dhe diferencat eventuale të reflektohen edhe në pasqyra financiare.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B4 - Mosprezantim i saktë i të hyrave të shtyra nga grantet**Gjetja**

Sipas SNK 20, Kontabiliteti i granteve pika 24 përcakton se, grantet që lidhen me aktivet, përfshirë grantet jo monetare me vlerë të drejtë, duhet të paraqiten në pasqyrën e pozicionit financiar duke e njohur grantin si të ardhur të shtyrë ose duke zbritur grantin që merret nga vlera e mbartur e aktivit. Po ashtu pika 17 përcakton se, grantet e marra për aktive të amortizueshme njihen si të ardhura gjatë periudhave në të cilat ngarkohet zhvlerësimi për ato mjete

Ne kemi vërejtur se trajtimi i të hyrave të shtyra nga grantet nuk ishte bërë në përputhje me standardet. Pa saktësitë e identifikuar janë si në vijim:

- Në pasqyrën e pozicionit financiar, grantet e shtyra janë prezantuar në vlerë 31,046,018€ ndërsa bazuar në shënimet e ndërmarrjes, vlera e aseteve të financuara nga grantet ishte 29,204,149€ duke rezultuar me një diferencë prej 1,841,868€. Po ashtu, ndërmarrja nuk ka arritur të sigurojë dëshmi mbështetëse për të vërtetuar se asetet e përfshira në këtë vlerë janë financuar nga grantet.
- Tutje, në pasqyrën e të ardhurave, të hyrat nga grantet ishin prezantuar në vlerë 1,240,436€ ndërsa bazuar në zhvlerësimin e aseteve të financuara nga grantet kjo shumë rezulton të jetë 851,984€.

Kjo situatë kishte ardhur si pasojë e mungesës së evidencave të rregullta në vitet e mëparshme, si dhe mos bartjes së informacionit dhe dokumentacionit përkatës nga menaxhmentet ndër vite.

Ndikimi

Mangësitë e identifikuar për këtë zë, përveç që nuk pasqyrojnë saktë vlerën e granteve, ndikojnë në prezantim dhe shpalosje jo të saktë të tyre edhe në pasqyra financiare.

Rekomandimi B4

Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë dokumentacionin përkatës për grantet në mënyrë që prezantimi i tyre të jetë i saktë në pasqyra financiare, si dhe të zbatojë harmonizime periodike ndërmjet regjistrave kontabël dhe të hyrave të shtyra. Po ashtu, të merren veprime për sigurimin dhe ruajtjen e dëshmive mbështetëse për grantet dhe asetet e financuara nga grantet.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**Çështja B5 - Mosprezantim i saktë i llogarive të pagueshme****Gjetja**

Sipas SNK 1, paragrafi 15, Pasqyrat financiare duhet të pasqyrojnë drejtë pozicionin financiar, performancën financiare dhe fluksin e mjeteve monetare të një njësie ekonomike. Paraqitja e drejtë kërkon një përfaqësim të besueshëm të efekteve të transaksioneve, ngjarjeve dhe kushteve të tjera në përputhje me përkufizimet dhe kriteret e njohjes për pasuritë, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet të përcaktuara në Kuadrin konceptual për raportimin financiar. Për më tepër, sipas Ligji Nr.06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, neni 12, kërkohet që Shoqëritë tregtare, verifikojnë të paktën një (1) herë në vit, ekzistencën dhe vlerësimin e pasurive, detyrimeve dhe kapitalit nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dëshmive të tyre mbështetëse nëpërmjet procesit të inventarizimit.

Ndërmarrja kishte prezantuar në pasqyrat financiare llogaritë e pagueshme në vlerë prej 116,024€, të cilat përfshijnë detyrime dhe parapagime. Megjithatë, sipas të dhënave kontabël, vlera e detyrimeve ishte 222,207€, ndërsa parapagimet në shumën prej 383,539€.

Gjatë vitit 2024, ndërmarrja nuk ka kryer harmonizime periodike me furnitorët, duke rezultuar që llogaritë e pagueshme të mos pasqyrojnë saktë gjendjen të tyre. Nga gjithsej 10 konfirmime të pranuar nga furnitorët kemi identifikuar pasaktësi, si në vijim:

- Në katër (4) raste, në regjistrin kontabël figuronin parapagime në vlerë prej 132,264€ ndërsa vlera e konfirmuar nga furnitorët ishte 0€.
- Në pesë (5) raste të tjera, sipas regjistrimeve kontabël, obligimet e ndërmarrjes ndaj furnitorëve ishin në vlerë prej 209,667€, ndërsa konfirmimet e pranuar nga furnitorët ishte 0€.
- Në një (1) rast tjetër, ndërmarrja kishte evidentuar parapagim në vlerë prej 54,051€, ndërkohë që sipas konfirmimit të furnitorit figuronte një borxh i papaguar në vlerë prej 1,700€.

Këto mospërputhje kanë ndodhur si rezultat i mungesës së kontrolleve të brendshme efektive në procesin e përgatitjes së pasqyrave financiare dhe mos kryerjes së harmonizimeve të rregullta ndërmjet evidencave kontabël dhe konfirmimeve nga furnitorët.

Ndikimi

Mospërputhjet ndërmjet regjistrave kontabël, pasqyrave financiare dhe konfirmimeve rrezikojnë besueshmërinë e informacionit financiar, si dhe prezantim jo të saktë të gjendjes të detyrimeve ose parapagimeve në pasqyrat financiare.

Rekomandimi B5

Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë që të dhënat në kontabilitet të jenë të sakta dhe të përputhen me pasqyrat financiare. Po ashtu, të sigurojë që, regjistri i detyrimeve të rishikohet në baza të rregullta kohore në mënyrë që të vërtetohet plotësia dhe saktësia e listës së detyrimeve dhe parapagimeve ndaj furnitorëve.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B6 - Mos prezantim i saktë i detyrimeve tjera

Gjetja

Korniza konceptuale paragrafi 4.26 përcakton se një detyrim është një obligim aktual i njësisë ekonomike për të transferuar një burim ekonomik si rezultat i ngjarjeve të kaluara.

Ndërmarrja në PFV kishte prezantuar detyrime tjera afatshkurtra në shumën prej 2,657,699€. Në kuadër të kësaj shume janë përfshirë detyrime për TVSh në vlerë prej 2,630,543€ dhe obligime për tatime dhe kontribute në paga në vlerë prej 27,156€. Megjithatë, krahasuar me të dhënat nga "Gjendja e përgjithshme e deklarimeve dhe transaksioneve të tatimpaguesit" nga ATK, detyrimi për TVSh rezulton të jetë zero, ndërsa detyrimi për tatime dhe kontribute është 38,183€.

Mangësitë e identifikuar janë si pasojë mos regjistrimit të saktë të tyre si dhe mos harmonizimit të detyrimeve në regjistrat kontabël me gjendjen e deklarimeve dhe borxheve në ATK.

Ndikimi Prezantimi i detyrimeve të cilat realisht nuk ekzistojnë ndikon në besueshmërinë e informacionit financiar dhe prezantim jo të saktë të detyrimeve në pasqyrat financiare.

Rekomandimi B6 Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë që obligimet tatimore të ndërmarrjes të harmonizohen me gjendjen e llogarive në ATK, në mënyrë që detyrimet të prezantohen saktë në pasqyrat financiare.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A7 - Mos prezantim i saktë i pasqyrës së rrjedhës së parasë

Gjetja Sipas SNK 1- një njësi ekonomike duhet të përgatit pakon e plotë të pasqyrave financiare e cila ka për qëllim të përgjithshëm të sigurojë informacione lidhur me pozicionin financiar, performacën financiare, fluksin monetar, si dhe shënimet shpjeguese të dobishme për përdoruesit e pasqyrave financiare vjetore. Qëllimi i pasqyrës së rrjedhës së parasë, sipas SNK 7, informacioni rreth fluksit monetar të një njësie ekonomike është i dobishëm për të pajisur përdoruesit e pasqyrave financiare me një informacion bazë për të vlerësuar aftësinë e njësisë ekonomike për të gjeneruar mjete monetare ose ekuivalentë të tyre dhe për të vlerësuar nevojat e njësisë ekonomike për të përdorur këto flukse monetare.

Ndërmarrja kishte hartuar pasqyrën e rrjedhës së parasë së gatshme, megjithatë rrjedha neto nga aktivitetet operative ishte mbivlerësuar për shumën 309,619€. Gjithashtu, te aktivitetet investuese, pagesat për blerjen e pronës, pajisjeve dhe impianteve ishin mbivlerësuar me 487,725€, ndërsa për pagesa të tjera investuese në shumën 85,230€, ndërmarrja nuk ka arritur të ofrojë dëshmi përkatëse që vërtetojnë këto pagesa.

Prezantimi jo i saktë i rrjedhës së parasë ka ndodhur si rezultat i pamundësisë së identifikimit të të gjitha korigjimeve, hyrjeve dhe daljeve të parave të cilat duhet të prezantojnë gjendjen e pasqyrës së rrjedhës së parave.

Ndikimi Trajtimi i gabuar te aktivitetet operative dhe investuese kanë ndikuar që pasqyra e rrjedhës së parasë së gatshme të mos prezantoj gjendjen e drejtë dhe të saktë.

Rekomandimi A7 Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë një analizë gjithëpërfshirëse të zërave të cilët kanë ndikuar në pasqyrën e rrjedhjes së parasë në mënyrë që PFV të prezantojnë një gjendje të drejtë dhe të vërtetë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B7 - Mangësi në shënimet shpjeguese**Gjetja**

SNK 1 përcakton se, shënimet shpjeguese janë një element i pandarë i pasqyrave financiare. Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare, prezantojnë informacionet shtesë në mënyrë që të plotësohen nevojat e përdoruesve me informacion mbi përbërjen e elementeve të bilancit dhe pasqyrës së të ardhurave. Ato zakonisht përmbajnë informacion edhe për politikat kontabël të përdorura nga njësia ekonomike për hartimin e pasqyrave financiare.

Në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare mungonin informata të rëndësishme të cilat janë të paraqitura në vijim:

- Ndërmarrja nuk kishte dhënë informacione shpjeguese për kërkesat që dalin nga standardet ndërkombëtare të kontabilitetit lidhur me përbërjen e investimeve në vijim.
- Shënimet shpjeguese nuk përmbajnë informacione, sipas kërkesave të SNK 2, lidhur me metodën e përdorur të njohjes së kostove të stoqeve.
- Te pasqyra e ndryshimeve në ekuitet, është prezantuar shuma 78,192€ me një sqarim të paqartë si “korigjim i rezultateve”, pa dhënë informacione të detajuara për natyrën e korigjimit, siç kërkohet nga SNK 8.
- Për të hyrat e shtyra nga grantet, ndërmarrja nuk ka dhënë informacione shpjeguese për politikat kontabël të përdorura për grantet, natyrën dhe madhësinë e granteve qeveritare të njohura në pasqyrat financiare, si dhe kushtet e paplotësuara të lidhura me ndihmën qeveritare.
- Shënimet shpjeguese nuk përmbajnë informacion, për ngjarjet të cilat i plotësojnë kushtet për trajtimin e tyre si pasuri/ detyrime kontingjente. Ato ngjarje ekonomike kanë të bëjnë me 11 lëndë gjyqësore.

Këto mangësi kishin ndodhur për shkak se kompania nuk kishte kontabilist të certifikuar dhe angazhimit të tij me vonesë, gjë që ka ndikuar në mungesën e informatave me kohë për të përfshirë në PFV.

Ndikimi

Mungesa e shpalosjeve kufizon qartësinë dhe transparencën e pasqyrave financiare, duke ndikuar në saktësinë e informacionit për përdoruesit.

Rekomandimi B7

Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë kontrolle të brendshme efektive në mënyrë që procesi i përgatitjes së pasqyrave financiare, të jetë në pajtim me kërkesat e standardit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B8 - Mos provizionimi i llogarive të arkëtueshme tregtare**Gjetja**

Sipas Standardit Ndërkombëtar të Raportimit Financiar 9 Instrumentet financiarë, një njësi ekonomike mund të llogaris humbjen e pritshme të kredisë për llogaritë e arkëtueshme tregtare duke përdorur një matricë provizionesh. Njësia ekonomike do të përdorë përvojën e saj historike për të vlerësuar humbjet e pritshme të kredisë për periudhën 12-mujore ose humbjet e pritshme të kredisë për tërë jetën e pasurisë financiare. Në varësi të larmisë së klientëve të saj, njësia ekonomike do të përdorë grupimet e përshtatshme në qoftë se përvoja e saj historike e humbjeve të kredisë tregon modele të ndryshme humbjeje për segmente të ndryshme të klientëve.

Ndërrmarja që nga viti 2015, nuk i kishte provizionuar llogaritë e arkëtueshme siç kërkohet me standard. Prej vlerës bruto të llogarive të arkëtueshme të shpalosjet në vlerë 18,937,668€, mbi 98% e tyre ishin më të vjetra se 1 vit prandaj ne nuk kemi mundur të marrim siguri se vlera bartëse neto prej 12,491,369€ e llogarive të arkëtueshme tregtare e prezantuar në pasqyra financiare është e saktë.

Më tutje, Ndërrmarja ende nuk kishte miratuar një rregullore për provizionimin e llogarive të arkëtueshme.

Përkundër rekomandimit nga vitet e kaluara, menaxhmenti nuk kishte aplikuar një politikë të përshtatshme dhe konsistente të provizionimit të llogarive të arkëtueshme. Kjo kishte ndodhur edhe si rezultat i mungesës së Bordit të Drejtorëve.

Ndikimi

Mos provizionimi i llogarive të arkëtueshme tregtare në nëntë vitet e fundit është në kundërshtim me kërkesat e standardeve të kontabilitetit për matjen e pasurisë financiare dhe ka ndikim material në vlerën neto të llogarive të arkëtueshme të prezantuara në pasqyrën e pozitës financiare.

Rekomandimi B8

Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë që të bëhen analiza gjithpërfshirëse në lidhje me aftësinë e pagesës së borxheve nga konsumatorët, kurse shuma e provizionit të përcaktohet sipas rregullores për zbatimin e procedurave dhe politikave afariste dhe Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK). Më tutje, të miratohet një rregullore për provizionimin e llogarive të arkëtueshme.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A8 - Mos lidhja e kontratave me konsumatorë dhe mungesa e emërimit të konsumatorëve

Gjetja

Ligji nr.05/L-042 për rregullimin e shërbimeve të ujit, neni 24, përcakton që ofruesi i shërbimeve duhet të lidhë kontratë me secilin konsumator ku përcaktohen kushtet e përgjithshme sipas të cilave do t'u ofrohen shërbime konsumatorëve. Po ashtu, Rregullorja e Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU) nr. 03/2016 për kartën e konsumatorit të shërbimeve të ujit në Kosovë, përmbajtja e regjistrit të konsumatorëve parasheh që regjistri i konsumatorëve ndër të tjera duhet të përmbajë: emrin dhe numrin personal të konsumatorit.

Ndërmarrja nuk kishte lidhur kontrata për ofrimin e shërbimeve me të gjithë konsumatorët të cilët marrin shërbimet e ujit. Sipas regjistrit të konsumatorëve për vitin 2024 ndërmarrja ofron shërbime për 59,575 konsumatorë, ndërkaq deri në fund të vitit 2024 kishte lidhur kontrata me vetëm 7,716 konsumatorë apo rreth 13% e tyre. Po ashtu në regjistrin e konsumatorëve ekzistojnë 186 konsumatorë të cilët janë evidentuar pa përshkrime (pa emër dhe mbiemër, numër personal të konsumatorit) dhe shkurtesa të tjera dhe se këta konsumatorë figurojnë të jenë në parapagim ndaj ndërmarrjes në vlerë 57,460€.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i numrit të madh të klientëve si dhe mos përgjigjes nga ana e klientëve në kërkesat e ndërmarrjes për nënshkrimin e kontratave për shërbime. Ndërsa evidentimi i konsumatorëve pa përshkrim të emrit të konsumatorit dhe numrit personal, kishte ndodhur në periudhat parake. Edhe përkundër përpjekjeve për identifikimin e tyre kjo gjë nuk është arritur të korrigohet as gjatë vitit 2024.

Ndikimi

Mungesa e kontratave me konsumatorë për shërbimet e ofruara dhe regjistrimi i tyre pa përshkrimin e të dhënave, përveç që nuk është në pajtim me kërkesat ligjore, pamundëson edhe aplikimin e masave ndaj këtyre konsumatorëve në rast të mos pagesës së borxhit.

Rekomandimi A8

Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë që të gjithë klientët që përfitojnë shërbime nga ndërmarrja të jenë të regjistruar me të dhënat përkatëse dhe të kenë të lidhur kontrata për furnizim me ujë, në përputhje me kërkesat ligjore dhe rregulloret në fuqi.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A9 - Realizimi i shpenzimeve pa ndonjë marrëveshje kontraktuale**Gjetja**

Sipas SNK1 (paragrafët 27 dhe 38) dhe Kuadrit Konceptual (paragrafët 4.42 dhe 4.43), pasqyrat financiare duhet të përgatiten mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara. Njohja e detyrimeve dhe shpenzimeve kërkon që ato të jenë aktuale, si pasojë e ngjarjeve të kaluara, dhe njësia të ketë marrë përfitime ekonomike ose të ketë ndërmarrë veprime që krijojnë obligim për transferim të burimeve ekonomike. Në këtë kuptim, njohja e shpenzimeve duhet të bazohet në dokumentacion të vlefshëm (p.sh. kontrata), që provon ekzistencën e detyrimeve të lindura.

Përmes testimit të shpenzimeve kemi identifikuar mangësitë në vijim:

- Ndërmarrja kishte realizuar shpenzime në vlerë prej 31,088€ për shërbime të telefonisë mobile pa ndonjë marrëveshje kontraktuale.
- Ndërmarrja kishte realizuar shpenzime në vlerë 1,740€ për furnizim dhe punime për ndarjen e kthinave në zyrë dhe në laboratorin e mikrobiologjisë, pa pasur marrëveshje kontraktuale për këto shërbime/furnizime.
- Në një rast, shpenzimet për furnizimin me kimikate për ITUN, të destinuara për analiza laboratorike, ishin nënvlerësuar për 3,476€, për shkak të mosregjistrimit të tyre sipas vlerës së furnizimit, por sipas vlerës së pagesës.

Kjo ka ndodhur për shkak se ndërmarrja kishte vazhduar pranimin e shërbimeve nga operatori ekonomik nën arsyetimin se vetëm ky operator kishte pasur shtrirje në zonat ku operon ndërmarrja, si dhe të mungesës së kontrollit të brendshëm nga ana e zyrtarëve përgjegjës.

Ndikimi

Realizimi i shpenzimeve pa kontratë rrit rrezikun e keqmenaxhimit të parasë publike, zvogëlon transparencën dhe mund të shkaktojë mosmarrëveshje për detyrimet midis palëve. Ndërsa nënvlerësimi i shpenzimeve ndikon në mbi vlerësimin e rezultatit financiar.

Rekomandimi A9

Bordi duhet të sigurojë që çdo shpenzim të bëhet vetëm pas lidhjes së një kontrate të rregullt dhe të vlefshme, në përputhje me ligjin për prokurim publik. Po ashtu, duhet të përforcohen kontrollet e brendshme për të parandaluar raste të ngjashme në të ardhmen.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Shpenzimet e pagave

Shpenzimet e pagave ishin 2,630,025€. Më 31 dhjetor 2024, ndërmarrja ka pasur gjithsej 257 të punësuar.

Çështja A10 - Gabime sistematike gjatë ekzekutimit të pagesave të tatimeve dhe kontributeve

Gjetja

Ligji nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës, Neni 6. Mbledhja e kontributeve për financimin e pensioneve të kursimeve individuale, 6.1 Çdo punëdhënës është i obliguar që të kontribuojë në emër të punonjësve të vet në Fondin e kursimeve pensionale. Punonjësit obligohen që të kontribuojnë në emër të vet në kursimet pensionale. Po ashtu, pika 6.3 kërkohej që punëdhënësi të zbrit kontributin pensional të punonjësve nga rrogat e punonjësve dhe të bartë në llogarinë e posaçme të fondit bashkë me kontributin e punëdhënësit në afatin e duhur në përputhje me rregullat që do të nxirren në mënyrën që e cakton Administrata Tatimore e Kosovës (ATK).

Gjatë vitit 2024 ndërmarrja për 12 punëtorë të saj kishte paguar kontributet dhe tatimet dy deri në katër herë për të njëjtën periudhë në vlerë totale prej 5,633€. Këto gabime ishin sistematike gjatë tërë vitit 2024.

Kjo kishte ndodhur për shkak të gabimeve teknike të softuerit, të cilat nuk u vunë re nga punonjësit gjatë gjithë vitit.

Ndikimi

Pagesa të shumfishta të kontributeve dhe tatimeve përgjatë periudhës krijojnë shpenzime të pambuluara. dhe si rezultat ndikojnë në shpenzime të paarsyeshme të parasë publike.

Rekomandimi A10

Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë funksionimin e plotë të kontrolleve të brendshme, përditësimin e softuerëve dhe trajnimin e stafit për të parandaluar gabimet teknike, si dhe kthimin e pagesave të parregullta për të shmangur shpenzime të paarsyeshme.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2023 të KRU "Hidrodrini", ka rezultuar në 10 rekomandime kryesore. Menaxhmenti i ndërmarrjes ka përgatitur planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2024, një (1) rekomandim ishte zbatuar dhe një (1) ishte mbyllur, ndërsa nëntë (8) rekomandime ende nuk ishin zbatuar. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shih Tabelën vijuese.

Grafiku 1. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 1 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2023	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për opinion	Bordi i Drejtorëve të sigurojë një rishikim gjithëpërfshirës të regjistrit të pasurisë dhe të ndërmarrë veprime konkrete, për rivlerësimin e vlerës dhe të jetës së dobishme të pasurive në çdo 3 deri në 5 vjet, me qëllim që vlera e pasurive në PFV-të e kompanisë të paraqitet drejtë dhe në përputhje me SNK 16.	Edhe këtë vit nuk janë marrë veprime konkrete për rivlerësimin e pasurisë.	Nuk ka filluar zbatimin
2.	Baza për opinion	Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë se gjatë hartimit të pasqyrave financiare janë harmonizuar të dhënat kontabël me zërat e pasqyrave financiare si dhe janë marrë të gjitha veprimet e nevojshme për harmonizimin vjetor të gjendjes së llogarive të arkëtueshme dhe klientëve të saj në baza periodike, në mënyrë që të konfirmohet vlera saktë e llogarive e pranuar nga dy palët.	Edhe këtë vit ka vazhduar gjendja e njëjtë.	Nuk ka filluar zbatimin

3.	Baza për opinion	Bordi i Drejtorëve të sigurojë prezantimin e saktë të detyrimit ndaj granteve dhe të hyrat nga grantet në pasqyrat financiare si dhe zbatimin e harmonizimeve periodike në mes të regjistrave kontabël për grantet me të hyrat e shtyra.	Edhe këtë vit ka vazhduar gjendja e njëjtë.	Nuk ka filluar zbatimin
4.	Baza për opinion	Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë se vlerat e llogarive të pagueshme prezantohen në PFV vetëm pasi të sigurohet se vlera e tyre në regjistrat e kontabilitet janë të plotë dhe të sakta.	Edhe këtë vit ka dobësi në prezantimin e llogarive të pagueshme në PFV.	Nuk ka filluar zbatimin
5.	Baza për opinion	Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë se janë ndërmarrë veprimet e nevojshme që obligimet tatimore të kompanisë të harmonizohen me gjendjen e llogarive në ATK, si edhe detyrimet afatshkurtra të harmonizohen me regjistrat kontabël dhe të prezantohen saktë në pasqyrat financiare vjetore.	Edhe këtë vit ka vazhduar gjendja e njëjtë.	Nuk ka filluar zbatimin
6.	Baza për opinion	Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë që të bëhen analiza gjithëpërfshirëse në lidhje me aftësinë e pagesës së borxheve nga konsumatorët, kurse shuma e provizionit të përcaktohet sipas rregullores për zbatimin e procedurave dhe politikave afariste dhe Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK).	Edhe këtë vit nuk ishte bërë provizionimi i llogarive të arkëtueshme	Nuk ka filluar zbatimin
7.	Baza për opinion	Bordi i Drejtorëve të sigurojë se para certifikimit të pasqyrave financiare, ato i nënshtrohen një procesi të rishikimit të hollësishëm në mënyrë që prezantimi i pasurisë afatgjatë si dhe zërit të investimeve në vijim të jetë i saktë dhe i plotë.	Kjo çështje është trajtuar në kuadër të çështjes A3.	Nuk është i aplikueshëm më
8.	Baza për konkluzion	Bordi i Drejtorëve të sigurojë se para miratimit të pasqyrave financiare, të vlerësoj se a ka ofruar menaxhmenti vlerësimet e duhura në mënyrë që përmbajtja e pasqyrave financiare të jetë e plotë dhe përmbajtësore në pajtim me kërkesat për përgatitjen e tyre sipas SNK.	Edhe këtë vit ka vazhduar gjendja e njëjtë.	Nuk ka filluar zbatimin
9.	Baza për konkluzion	Bordi i Drejtorëve duhet të vendos një sistem për qarkullim të dokumentacionit të brendshëm si dhe të sigurojë funksionimin e këtij sistemi brenda kompanisë për evidentimin dhe ruajtjen e të gjithë dokumentacionit sipas kërkesave ligjore.		I zbatuar
10.	Llogaritë e arkëtueshme	Bordi i Drejtorëve të sigurojë që janë marrë veprimet e duhura për të identifikuar konsumatorët të cilët i kanë kryer pagesat e grumbulluara në llogarinë "Konsumatorë i paidentifikuar" dhe se klientëve të identifikuar, u janë zbritur obligimet e papaguara ndaj kompanisë.	Edhe këtë vit janë identifikuar regjistrime të tilla.	Nuk ka filluar zbatimin

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Mehmet Mucaj, Drejtor i Auditimit



Ganimete Dalloshi, Udhëheqëse e ekipit



Neslihane Mati, Anëtare e ekipit



Arbresha Grainca, Anëtare e ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi

Leter konfirmimi



LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2024 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të "Hidrodrini" sh. a., për vitin 2024;
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Z. DRI CENA

Kryshefi Ekzekutiv i "Hidrodrini" sh. a.,

Data: 17.06.2025, Pejë,



Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante.
- ² Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet

Pasqyrat Financiare 2024
K.R.U. HIDRODRINI SH.A.

NUI: 811336975

Pasqyra e pozitës financiare
Më 31 Dhjetor 2024

	Shënimi	2024 €	2023 €
PASURITË			
Pasuritë afatshkurtra			
Paraaja dhe ekuivalentët e parasë	1	1,402,831	2,562,882
Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera	3	12,787,284	12,478,178
Stoqet	2	702,875	589,455
Pasuritë e tjera afatshkurtra	4	1,481,504	803,818
		16,374,495	16,433,333
Gjithsej pasuritë afatshkurtra			
Pasuritë afatgjata			
Prona, pajisjet dhe impiantet	5	12,999,217	13,109,835
Investimet në vijim		26,213,266	25,835,213
Pasuritë e paprekshme		-	-
Pasuritë e shtyra tatimore		-	-
Pasuritë e tjera afatgjata		-	-
		39,212,482	38,945,048
		55,586,977	55,379,381
DETYRIMET DHE EKUITETI			
DETYRIMET			
Detyrimet afatshkurtra			
Mbitërheqja bankare		-	-
Kredi dhe Huat afatshkurtra		-	-
Llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera	6	116,024	3,564
Detyrimet tatimore	7	2,657,699	2,016,697
Detyrimet e tjera afatshkurtra		-	-
Detyrime ndaj fitimit ne tatim		-	-
		2,773,723	2,020,261
Gjithsej detyrimet afatshkurtra			
Detyrimet afatgjata			
Të hyrat e shtyra nga grantet	8	31,046,018	31,757,032
Detyrimet e tjera afatgjata		-	-
Kredi dhe Huat afatgjata		-	-
		31,046,018	31,757,032
		33,819,740	33,777,293
Gjithsej detyrimet			

EKUITETI

Kapitali aksionar	25,000	25,000
Fitimet e mbajtura	-2,318	-167,465
Rezervat e tjera	21,744,554	21,744,554
Gjithsej ekuiteti	21,767,236	21,602,088
Gjithsej ekuiteti dhe detyrimet	55,586,977	55,379,381

Kryeshef Ekzekutiv

Zyrtari Kryesor Financiar

Kontabilist i Çertifikuar

Dri Cena

Besnik Zeqriaj

Ilir Lajqi



**Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse
për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2024**

	Shënimi	2024 €	2023 €
Të hyrat	9	4,604,890	4,417,482
Kmsh		(128)	(36,366)
Fitimi / (humbja) bruto		4,604,762	4,381,116
Te hyrat e shtyera nga grantet (shënimi 9)		1,240,436	872,656
Shpenzimet e pagave	10	(2,630,025)	(2,174,762)
Shpenzimet e përgjithshme dhe administrative	11	(1,013,502)	(1,069,651)
Shpenzimet e shpërndarjes	12	(209,025)	(288,831)
Shpenzimet e zhvlerësimit	5	(1,722,067)	(1,673,018)
Fitimi / (humbja) operativ		270,378	47,510
Shpenzimet financiare		-	-
Të ardhurat financiare		-	-
Fitimi / (humbja) para tatimit		270,378	47,510
Shpenzimet e tatimit në fitim	13	(27,038)	(4,751)
Fitimi / (humbja) i/e vitit		243,340	42,759
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse:			
Diferencat këmbimore nga përkthimi i pasqrave financiare te operacioneve të huaja, neto nga tatami		-	-
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse të vitit		-	-
Gjithsej të ardhurat / (humbjet) gjithëpërfshirëse të vitit		243,340	42,759

**Pasqyra e ndryshimit ne ekuitet
për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2024**

	Kapitali aksionar	Rezervat tjera	Humbja e bartur	Gjithsej
Balanca me 1 janar 2023	25,000	21,744,554	(220,788)	21,548,776
Fitimi i vitit			42,759	42,759
Diferencat nga perkthimet valutore				
Dividendat	-	-		
Deponimet e kapitalit shtesë				
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	-
Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse	-	-	42,759	42,759
Korrigjim	-	-	10,563	10,563
Balanca me 31 dhjetor 2023	25,000	21,744,554	(167,466)	21,602,088
Balanca me 1 janar 2024	25,000	21,744,554	(167,466)	21,602,088
Fitimi i vitit/Humbja	-	-	243,340	243,340
Diferencat nga perkthimet valutore				
Dividendat	-	-	-	-
Deponimet e kapitalit shtesë				
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	-
Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse	-	-	243,340	243,340
Korrigjim *	-	-	(78,192)	(78,192)
Balanca me 31 dhjetor 2024	25,000	21,744,554	(2,318)	21,767,236

*Korrigjim *78,192 si rezultat i ndryshimeve ne fitimin e mbajtur te vitit*

**Pasqyra e rrjedhjes së parasë
për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2024**

Shënimi	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Flukset e parasë nga aktivitetet operative		
Fitimi para tatimit	270,378	47,510
<i>Korigjimet:</i>		
Shpenzimet e zhvlerësimit	5 1,722,067	1,673,018
Dëmtimi i pronës, pajisjeve dhe impianteve	-	-
Rritja/zvogelimi në pasuri tjera financiare	-	-
(Fitimi) / humbja nga shitja e pronës, fabrikës dhe pajisjeve	-	-
Shpenzimet e tatimit në fitim	-	-
	1,992,446	1,720,528
Fitimi operativ para ndryshimeve në kapitalin punues		
Ndryshimi në stoqe	2 (113,420)	24,421
Ndryshimi në të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera	3 (309,106)	(675,966)
Ndryshimi në parapagimet dhe kërkesat tjera	4 (677,686)	(359,197)
Ndryshimi në të hyrat e shtyra	8 (711,013)	701,038
Ndryshimi në të pagueshmet tregtare dhe të tjera	6 112,460	(197,105)
Ndryshimi në detyrimet tatimore	7 641,002	10,418
Paraja e gjeneruar nga aktivitetet operative	934,681	1,224,137
Tatimi në fitim i paguar	(20,000)	(19,179)
Flukset neto të parasë nga aktivitetet operative	914,681	1,204,958
Flukset e parasë nga aktivitetet investuese		
Blerje e aktiveve të qëndrueshme	(1,989,502)	(2,371,965)
Shitje e aktiveve të qëndrueshme	-	-
Pagesat për blerjet e pasurive të paprekshme	-	-
Arkëtimet për shitjen e pasurive të paprekshme	-	-
Interesi i arkëtuar	-	-
Dividendat e arkëtuara	-	-
Arkëtimet/Pagesat tjera investuese -Korigjim	(85,230)	(310,338)
Flukset e parasë të gjeneruara nga aktivitetet investuese	(1,160,051)	(1,477,345)
Flukset e parasë nga aktivitetet financuese		
Deponimet e kapitalit shtesë	-	-
Dividendat e paguara	-	-
Arkëtimet nga kreditë dhe huatë	-	-
Ripagimi i kredive dhe huave	-	-

KRU Hidrodrini Sh.A.

Shënime në pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2024
(Shumat në Euro)

1. Informata mbi kompaninë

KRU Hidrodrini Sh.A. ("Shoqëria") është themeluar si shoqëri aksionare me 01.06.2007 në Kosovë, sipas projektit për Korporatizimin e Sektorit të Ujit në Kosovë, me numër të biznesit 70433918, numër fiskal 600198867, dhe me numër unik identifikues 811336975. Shoqëria operon në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-016 për "Shoqëritë Tregtare", dhe Ligjit Nr. 04/L-026 për "Markat tregtare", siç është ndryshuar dhe plotësuar nga Ligji Nr. 05/L-040.

Shoqëria ka adresë operimi në Pejë, Rruga Lekë Dukagjini nr.156.

Shoqëria ka 1 (një) aksionar: Qeverinë e Republikës së Kosovës, që zotëron 100 % të aksioneve.

Aktiviteti primar i shoqërisë është grumbullimi, trajtimi dhe furnizimi me ujë. Ndërsa aktiviteti sekondar është testi i shpuarjes dhe shpuarja.

KRU Hidrodrini Sh.A. ka 5 pika operuese:

KRU Hidrodrini Sh.A. Junik;

KRU Hidrodrini Sh.A. Pejë;

KRU Hidrodrini Sh.A. Deçan;

KRU Hidrodrini Sh.A. Istog; dhe

KRU Hidrodrini Sh.A. Klinë.

Më 31 dhjetor 2024 kompania kishte 257 punonjës (31 dhjetor 2023: 268 punonjës).

2. Deklarata e përputhshmërisë

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF"), të cilat janë në aplikim në Kosovë me aprovimin nga KKRF.

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël

3.1 Baza e përgatitjes

Këto pasqyra financiare janë përgatitur me parimin e kostos historike. Këto pasqyra financiare janë prezantuar në EURO, e cila është monedha funksionale e shoqërisë.

3.2 Prona, Ndërtesa dhe pajisjet

Ndërtesat dhe pajisjet janë të mbajtura në pasqyrat e pozicionit financiar në vlerën e tyre të kostos minus zhvlerësimin e akumuluar dhe çdo humbje nga dëmtimi, nëse ka ndonjë (referojuni te shënimi Nr.4). Kosto përfshin shpenzimet që janë drejtpërdrejtë të lidhura me blerjen e pasurisë. Zhvlerësimi ngarkohet në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse në bazë të jetëgjatësisë së vlerësuar të secilës pasuri duke përdorur metodën lineare.

Normat e zhvlerësimit të mëposhtme zbatohen për periudhat aktuale dhe krahasuese:

Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)**3.2 Prona, Ndërtesa dhe pajisjet (vazhdim)**

	2023	2024
Toka	0 %	0 %
Ndërtesa	5 %	5 %
Rrjeti i ujësjellësit dhe instalimet teknike	20 %	20 %
Pajisjet, makineritë, veturat, IT, etj.	20 %	20 %
Investimet në vijim	0 %	0 %

Metoda e zhvlerësimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi.

3.3 Tatimi në fitim

Tatimi jepet në pasqyrat financiare në përputhje me legjislacionin tatimor të Kosovës aktualisht në fuqi, Ligji Nr. 05/L-29 "Mbi Tatimin në të Ardhurat e Korporatave".

Shpenzimet e tatimit për periudhën përfshijnë tatimin aktual dhe të shtyrë. Tatimi njihet në fitim ose humbje, përveç pjesës që lidhet me zëra të njohura direkt në kapital ose në të hyra tjera gjithëpërfshirëse.

Tatimi i shtyrë pasuri njihet vetëm në atë masë sa është e mundur që fitimi i tatuashëm i ardhshëm do të jetë në dispozicion kundër të cilit mund të përdoren diferencat e përkohshme.

Tatimi i shtyrë pasuri rishikohet në çdo datë raportimi dhe zvogëlohet në atë masë që ajo nuk është më e mundur që përfitimet nga tatimi do të realizohen.

Ngarkesa aktuale e tatimit mbi të ardhurat llogaritet në bazë të ligjeve tatimore në fuqi ose në datën e raportimit. Menaxhmenti periodikisht vlerëson qëndrimet e marra në deklaratat tatimore në lidhje me situatat në të cilat rregulloret e zbatueshme tatimore janë subjekt i interpretimit. Ajo përcakton provizione kur është e nevojshme në bazë të shumave që pritet të paguhen në organet tatimore.

3.4 Paraja dhe ekuivalentët e parasë

Paraja dhe ekuivalentët e parasë përfshijnë paratë në dorë dhe në llogaritë operative në bankë me afat maturimi tre muaj ose më pak.

3.5 Llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera

Detyrimet tregtare dhe shumat e tjera të pagueshme janë matur në kosto që është vlera e drejtë e shumës për t'u paguar në të ardhmen për mallrat dhe shërbimet e pranuar nëse i është faturuar kompanisë apo jo.

3.6 Njohja e të ardhurave

Të ardhurat nga shitja e mallrave njihen kur kontrolli i mallrave është transferuar, mallrat janë dorëzuar në vendndodhjen specifike të klientit. Një llogari e arkëtueshme njihet nga kompania kur mallrat janë dorëzuar pasi që kjo paraqet kohën në të cilën e drejta për shqyrtim bëhet e pakushtëzuar, pasi vetëm kalimi i kohës kërkohet para pagesës.

Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme dhe përfaqësojnë shumën e arkëtuar për mallrat dhe shërbimet e ofruara gjatë rrjedhës normale të biznesit, neto e kthimit të konsumatorëve, zbritjet dhe tatimet e lidhura me shitje.

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

3.6 Njohja e të ardhurave (vazhdim)

Të ardhurat nga shitja e mallrave njihen kur të gjitha kushtet e mëposhtme janë përmbushur:

- (i) kompania ka transferuar te blerësit rreziqet e rëndësishme dhe përfitimet e pronësisë së mallrave;
- (ii) kompania nuk e ruan as përfshirjen e vazhdueshme menaxheriale në nivelin që zakonisht lidhet me pronësinë dhe as kontrollin efektiv mbi mallrat e shitura;
- (iii) është e mundur që përfitimet ekonomike të lidhura me transaksionin të rrjedhin tek entiteti; dhe
- (iv) shpenzimet e bëra ose që do të bëhen në lidhje me transaksionin mund të maten e besueshmëri.

3.7 Transaksionet në valuta të huaja

Transaksionet në monedhë të ndryshme nga monedha funksionale (monedha të huaja) regjistrohen me kursin e këmbimit që mbizotëron në datën e kryerjes së transaksioneve. Në çdo datë të bilancit, zërat monetarë të shprehur në monedhë të huaj konvertohen me normat mbizotëruese në datën e bilancit të gjendjes. Zërat jo monetarë që maten në termat e kostos historike në monedhë të huaj nuk konvertohen. Diferencat e këmbimit që rrjedhin nga zërat monetarë, janë të përfshira në fitimin dhe humbjen e periudhës në të cilën lindin.

3.8 Rënia në vlerë

Vlera kontabël e pasurive të kompanisë, me përjashtim të stoqeve rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka evidenca për rënie në vlerë. Nëse ka tregues të tillë, shuma e rikuperueshme e pasurisë vlerësohet.

Një humbje nga rënia në vlerë njihet kur vlera kontabël e një pasurie ose e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare tejkalon shumën e rikuperueshme. Humbjet nga rënia në vlerë njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes. Për një pasuri që nuk gjeneron rrjedha hyrëse të parasë të pavarura, shuma e rikuperueshme përcaktohet për njësinë gjeneruese të mjeteve monetare të cilës i përkasin pasuritë.

Në lidhje me pronat, impiantet dhe pajisjet, një humbje nga rënia në vlerë rimerret nëse ka pasur një ndryshim në vlerësimet e përdorura për përcaktimin e vlerës së rikuperueshme.

3.9 Të hyrat dhe shpenzimet financiare

Të hyrat financiare përfshijnë të hyrat e interesit në bilancat e bankave të njohura në fitim ose humbje. Të hyrat nga interesi njihen si akruale, duke përdorur metodën efektive të interesit. Shpenzimet e interesit njihet në pasqyrën e fitimit ose humbjes në bazë akruale duke përdorur metodën efektive të interesit.

3.10 Përfitimet e punonjësve

Kompania nuk ndan asnjë provizion dhe nuk ka obligim për pensionet e punonjësve më të madha se kontributet e paguara në Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës.

3.11 Kontingjentat dhe provizionet

Detyrimet kontingjente nuk janë njohur në pasqyrat financiare. Ato janë shpalosur përveq nëse mundësia e rrjedhës së burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët.

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

3.11 Kontingjencat dhe provizionet (vazhdim)

Pasuria kontingjente nuk është njohur në pasqyrat financiare por është shpalosur kur rrjedhja e përfitimeve ekonomike është e mundshme.

Provizioni është njohur nëse kompania ka një detyrim aktual (ligjor ose konstruktiv) si rezultat i ngjarjeve të mëparshme, është e mundur që një dalje e burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike do të kërkohet për të shlyer detyrimin; dhe një vlerësim i besueshëm mund të bëhet për shumën e obligimit.

3.12 Parimi i vazhdimësisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi parimin e vazhdimësisë, e cila supozon realizimin e pasurive dhe shlyerjen e detyrimeve në rrjedhën normale të biznesit.

3.13 Gjykimet kritike dhe burimet kyçe të pasigurisë së vlerësuar

Në procesin e zbatimit të politikave të kontabilitetit të kompanisë, të cilat janë të përshkruara më sipër, menaxhmenti nuk ka bërë asnjë gjykim që ka ndikim të rëndësishëm në shumat e njohura në pasqyrat financiare. Supozimet kyçe lidhur me të ardhmen, dhe burime të tjera kyçe të vlerësimit të pasigurisë në datën e raportimit, që rrezikojnë të shkaktojnë një rregullim material në vlerën kontabël të pasurive dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar, janë diskutuar më poshtë:

Detyrimi aktual tatimor

Pasqyrat financiare të kompanisë për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2023 i nënshtrohen inspektimit nga autoritetet tatimore vendore, ku menaxhmenti i kompanisë ka përdorur vlerësimin dhe gjykimin e tij më të mirë, për të qenë në përputhje me ligjet tatimore. Për shkak të përdorimit të gjykimin për të përmbushur kërkesat e caktuara të ligjeve tatimore dhe në varësi të vlerësimit të autoriteteve tatimore, detyrimi tatimor më 31 dhjetor 2023 mund të ndryshojë në krahasim me atë të raportuar në këto pasqyra financiare.

Provizioni për dëmtim të llogarive të arkëtueshme dhe rënien në vlerë të stoqeve

Në rrjedhën normale të biznesit, kompania bën vlerësim për rikuperimin dhe realizimin e llogarive të arkëtueshme dhe stoqeve. Bazuar në këtë vlerësim, menaxhmenti regjistron një provizion përkatës për dëmtimin e llogarive të arkëtueshme dhe rënien në vlerë të stoqeve.

Faktorët dhe rrethanat e shqyrtuara nga menaxhmenti me datën e raportimit nuk rezultojnë në provizionim të llogarive të arkëtueshme.

KRU Hidrodrini Sh.A.

Shënime në pasqyrat financiare për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024
(Shumat në Euro)

1 Paraja dhe ekuivalentët e parasë

Paraja dhe ekuivalentët e parasë me 31 dhjetor 2024 janë të përbëra si në vijim:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Paraja në bankë	1,402,636	2,560,661
Paraja në arkë	194	2,221
Gjithsej	1,402,831	2,562,882

2.Stoqet

Stoqet janë të përbëra si në vijim:

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2023
Depo Pejë	612,372	494,183
Depo Istog	46,336	43,795
Depo Klinë	16,572	17,429
Depo Junik	6,794	8,192
Depo Deçan	20,801	25,862
Gjithsej	702,795	589,461

3.Të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera

Të arkëtueshmet tregtare janë të përbëra si në vijim:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Kërkesat bruto	18,937,668	18,882,956
Lejimi për borxhin e keq	(6,446,299)	(6,546,758)
Të arkëtueshmet neto	12,491,369	12,336,198
Të arkëtueshmet tjera	295,915	141,980
Gjithsej të arkëtueshmet tjera	295,915	141,980
Gjithsej të arkëtueshmet	12,787,284	12,478,178

4.Parapagimet dhe kërkesat tjera

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Tvsh e zbritshme	1,167,266	723,201
Parapagimet e furnitorëve	240,445	23,811
Parapagimi i tatimit në fitim	43,192	27,874
Akontacionet ndaj punëtorëve	7,398	6,001
Kërkesat nga institucionet financiare	-	-
Parapagimi i sigurimit të automjeteve	23,203	20,396
Parapagimi i pagave	-	2,535
Gjithsej	1,481,504	803,818

KRU Hidrodrini Sh.A.

Shënime në pasqyrat financiare për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024

(Shumat në Euro)

5.Toka, prona dhe pajisjet

	Toka	Ndërtesat	Rrjeti i Ujësjiellit dhe instalimet teknike	Pajisjet, makineritë, veturat, IT, etj.	Investimet në vijim	Gjithsej
<i>Kosto historike</i>						
Më 31 dhjetor 2022	2,304,250	6,385,865	24,432,203	2,306,956	24,909,102	60,338,375
Shtesat	-	71,717	1,374,137	-	926,111	2,371,965
Heqjet	-	-	-	(38,116)	-	(38,116)
Më 31 dhjetor 2023	2,304,250	6,457,582	25,806,340	2,268,840	25,835,213	62,672,224
Shtesat	-	-	1,611,449	-	378,053	1,989,502
Korrigjim	-	-	-	-	-	-
Më 31 dhjetor 2024	2,304,250	6,457,582	27,417,789	2,268,840	26,213,266	64,661,726
						152,877
<i>Zhvlerësimi i akumuluar</i>						
Më 1 janar 2023	-	(3,546,799)	(17,576,084)	(2,411,591)	-	(23,534,474)
Shtesat	-	(320,578)	(1,197,324)	(155,116)	-	(1,673,018)
Heqjet	-	-	-	-	-	-
Më 31 dhjetor 2023	-	(3,867,377)	(18,773,408)	(2,566,707)	-	(25,207,492)
Shtesat	-	(323,906)	(1,226,111)	(172,050)	-	(1,722,067)
Heqjet	-	-	-	-	-	-
Më 31 dhjetor 2023	-	(4,191,283)	(19,999,519)	(2,738,757)	-	(26,929,559)
Asete te pa aktivizuara						1,480,316
<i>Vlera neto në libra</i>						
Si më 31 dhjetor 2023	2,304,250	2,590,205	7,032,932	(297,867)	25,835,213	38,945,048
Si më 31 dhjetor 2024	2,304,250	2,266,299	7,418,269	*(469,917)	26,213,266	39,212,482

*Vlera 469,917 është korrigjim i paisjeve, makinerive veturave etj. pasi ka vlerë më të madhe zhvlerësimi se sa vlera e aseteve

KRU Hidrodrini Sh.A.

Shënime në pasqyrat financiare për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024

(Shumat në Euro)

6.Të pagueshmet tregtare dhe të tjera

Të pagueshmet tregtare dhe të tjera përbëhen nga si vijon:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Të pagueshmet tregtare	116,024	-
Të pagueshmet tjera	-	3,564
Pagat e pagueshme	-	-
Gjithsej	116,024	3,564

7. Detyrimet tatimore

Detyrimet tatimore si më 31 dhjetor 2024 ishin:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Detyrimi për tvsh	2,630,543	1,981,008
Detyrimi për kontributin pensional	23,267	27,874
Detyrimi për tatimin në paga	3,888	7,815
Tatimi në qira	-	-
Gjithsej	2,657,699	2,016,697

8.Të hyrat e shtyra

Të hyrat e shtyra janë të përbëra si në vijim:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Të hyrat e shtyra KFW	19,866,119	20,468,166
Të hyrat e shtyra CDS Zvicër	501,953	533,705
Të hyrat e shtyra MZHE	1,230,238	1,110,072
Të hyrat e shtyra Komuniteti	14,206	15,340
Të hyrat e shtyra USAID	1,383,256	1,504,753
Të hyrat e shtyra KK Pejë	3,084,975	3,084,975
Të hyrat e shtyra Klinë	1,165,115	1,249,865
Të hyrat e shtyra MMPH	3,790,156	3,790,156
Gjithsej	31,046,018	31,757,032

9.Të hyrat nga shërbimet dhe të hyrat tjera

Të hyrat nga shërbimet dhe të hyrat tjera si më 31 dhjetor 2024 ishin:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Të hyrat nga shërbimet	4,603,380	4,362,095
Gjithsej të hyrat nga shërbimet	4,603,380	4,362,095
Të hyrat për asetet e zhvlerësuar nga grantet	1,240,436	872,656
Të hyrat nga borxhi i keq	-	-
Të hyrat tjera	1,510	55,387
Gjithsej të hyrat tjera	1,241,946	928,043
Gjithsej të hyrat	5,845,326	5,290,138

KRU Hidrodrini Sh.A.

Shënime në pasqyrat financiare për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024

(Shumat në Euro)

10. Shpenzimet e pagave

Shpenzimet e personelit përbëhen nga si vijon:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Paga dhe mëditje	2,427,840	1,995,595
Kontributet pensionale nga punëdhënësi	121,124	99,442
Kontributet shëndetsore	81,061	79,725
Gjithsej	2,630,025	2,174,762

11. Shpenzimet e përgjithshme dhe administrative

Shpenzimet e përgjithshme dhe administrative përbëhen nga si vijon:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Shpenzimet e energjisë elektrike	679,036	658,060
Shpenzimet e borxheve të këqija dhe dyshimta	21,575	28,214
Shpenzimet e jashtme profesionale dhe udhëtimet zyrtare	36,653	54,386
Shpenzimet e analizave të ujit dhe klorit	98,107	87,870
Shpenzimet e licencimit	58,846	71,307
Shpenzimet e zyrës	27,927	14,994
Shpenzimet e telefonit dhe internetit	28,448	23,978
Shpenzimet e ngrohjes, mbeturinave dhe rrjetit të ujit	4,214	3,055
Shpenzimet e donacioneve	-	1,500
Shpenzimet e provizionit bankar	19,119	5,943
Shpenzimet e përfaqësimit	2,174	3,573
Shpenzimet komunale	1,884	4,513
Shpenzimet e gjobave	500	17,642
Shpenzimet e polimerit	23,701	78,258
Shpenzimet tjera jo materiale	11,318	16,397
Gjithsej	1,013,502	1,069,690

12. Shpenzimet e shpërndarjes

Shpenzimet e shpërndarjes përbëhen si vijon:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Shpenzimet e mirëmbajtjes/servisimit	84,917	143,709
Kosto e mallit të shitur	-	-
Shpenzimet tjera të shpërndarjes	9,694	22,140
Shpenzimet e karburanteve	82,798	100,702
Shpenzimet e sigurimit/regjistrimit	12,397	7,059
Shpenzimet e reklamës	4,644	7,493
Shpenzimet e qirasë	14,776	7,728
Gjithsej	209,225	288,831

KRU Hidrodrini Sh.A.

Shënime në pasqyrat financiare për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024

(Shumat në Euro)

13. Shpenzimi i tatimit në fitim

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Fitimi para tatimit	270,378	47,510
<i>Korrigjime për:</i>		
Shpenzimet e pazbritshme	-	-
Humbja e bartur	-	-
Fitimi/Humbja bazë për tatim	270,378	47,510
Tatimi 10 %	27,038	4,751

Tatimi në fitim në Kosovë është në normën prej 10 % në vitin 2024 (2023: 10 %) të ardhurave të tatueshme.

Zotimet dhe kontingjentet**(i) Zotimet**

Kompania për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024 nuk kishte zotime apo detyrime kontigjente.

(ii) Kontestet

Me 31 dhjetor 2024, kompania nuk është e përfshirë në asnjë çështje gjyqësore nga aktiviteti i biznesit.

Instrumentet financiare – Vlera e drejtë dhe menaxhimi i riskut**Vlera e drejtë**

Kompania ka pasuri financiare të cilat përbëhen nga llogaritë e arkëtueshme, paraja dhe ekuivalentët e saj. Kompania ka detyrime financiare të cilat përbëhen nga akrualet, kreditë dhe të pagueshmet e tjera. Vlerat e drejta të këtyre instrumenteve financiare nuk janë materialisht të ndryshme nga vlera e tyre e deklaruar për shkak të maturitetit të tyre të shkurtër ose kushteve të tjera.

Menaxhimi i rrezikut

Kompania ka ekspozim ndaj këtyre risqeve të cilat lindin nga instrumentet financiare në posedim:

- (i) *Rreziku kreditor*
- (ii) *Rreziku i likuiditetit*
- (iii) *Rreziku i tregut*

(i) Rreziku kreditor

Instrumentet financiare të cilat potencialisht e ekspozojnë kompaninë ndaj përqendrimeve të rrezikut kreditor përbëhen kryesisht nga balancat e të arkëtueshmeve dhe parave të gatshme. Ekspozimi i kompanisë ndaj rrezikut kreditor ndikohet kryesisht nga karakteristikat individuale të secilit klient. Kompania ka krijuar një politikë kreditore nën të cilën secili klient i ri analizohet individualisht për besueshmëri para se termat dhe kushtet e pagesës dhe të dërgesës të ofrohen. Rreziku kreditor i të arkëtueshmeve kontrollohet me anë të aprovimeve të arkëtueshmeve dhe shpenzimeve buxhetore që i gjenerojnë të arkëtueshmet e tilla.

KRU Hidrodrini Sh.A.

Shënime në pasqyrat financiare për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024

(Shumat në Euro)

Instrumentet financiare – Vlera e drejtë dhe menaxhimi i riskut (vazhdim)**(i) Rreziku kreditor (vazhdim)**

Si me 31 dhjetor 2024 të arkëtueshmet dhe lejimet për borxhet e këqija janë të rëna në vlerë si vijon:

	Më 31 dhjetor 2024	Më 31 dhjetor 2023
Të arkëtueshmet bruto	19,233,583	19,024,936
Lejimi për borxhet e këqija	(6,446,299)	(6,546,758)
Të arkëtueshmet neto	12,787,284	12,478,178

Menaxhmenti krijon lejime për rëniet në vlerë të të arkëtueshmeve të cilat përfaqësojnë vlerësimin e tij për humbjet e ndodhura në lidhje me të arkëtueshmet. Si me 31 dhjetor 2023 menaxhmenti vlerëson që të arkëtueshmet nuk janë të rëna në vlerë.

Rreziku kreditor në paratë e gatshme kontrollohet duke investuar në bankat me reputacion në Kosovë.

Paqëndrueshmëria në tregjet financiare botërore dhe ato të Kosovës

Kriza e vazhdueshme botërore financiare dhe kriza ekonomike ka rezultuar në, ndër të tjera, një nivel më të ulët të financimit të tregut të kapitaleve, nivele më të ulëta të likuiditetit në sektorin bankar, dhe kohë pas kohe, norma më të larta ndërbankare interesi dhe paqëndrueshmëri më të lartë në tregjet e aksioneve. Pasiguritë në tregjet globale financiare kanë rezultuar edhe në dështime të bankave dhe shpëtime të bankave në të gjithë botën. Shtrirja e plotë e ndikimit të krizës financiare së vazhdueshme po dëshmon të jetë e pamundur për t'u parashikuar ose për t'u mbrojtur plotësisht nga ajo.

(ii) Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit rrjedh nga financimi i përgjithshëm i aktiviteteve të kompanisë dhe menaxhimi i pozicioneve. Përfshinë edhe rrezikun e të mos qenit në gjendje për të financuar pasurinë me maturitet dhe norma të përshtatshme dhe rrezikun e të mos qenit në gjendje për të likuiduar një pasuri me një çmim të arsyeshëm dhe afat kohor të përshtatshëm për të përmbushur detyrimet. Kompania e monitoron likuiditetin e saj në baza mujore me qëllim që të menaxhojë obligimet e saj kur ato vijnë për t'u përmbushur. Maturiteti kontraktual i instrumenteve financiare të kompanisë me 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2024 është si në vijim:

Instrumentet financiare – Vlera e drejtë dhe menaxhimi i riskut (vazhdim)

(ii) Rreziku i likuiditetit (vazhdim)

31 dhjetor 2023	Më pak se një muaj	1 deri në 12 muaj	1 deri në 5 vjet	Gjithsej
Pasuritë				
Paraja në dorë dhe në bankë	2,562,882	-	-	2,562,882
Të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera	12,478,178	-	-	12,478,178
Gjithsej pasuritë	15,041,060	-	-	15,041,060
Detyrimet				
Llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera	3,564	-	-	3,564
Gjithsej detyrimet	3,564	-	-	3,564
Pozita e likuiditetit	15,037,496	-	-	15,037,496
Hendeku i likuiditetit	15,037,496	15,037,496	15,037,496	
31 dhjetor 2024	Më pak se një muaj	1 deri në 12 muaj	1 deri në 5 vjet	Gjithsej
Pasuritë				
Paraja në dorë dhe në bankë	1,402,831	-	-	1,402,831
Të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera	12,787,284	-	-	12,787,284
Gjithsej pasuritë	14,190,116	-	-	14,190,116
Detyrimet				
Llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera	116,024	-	-	116,024
Gjithsej detyrimet	116,024	-	-	116,024
Pozita e likuiditetit	14,074,092	-	-	14,074,092
Hendeku i likuiditetit	14,074,092	14,074,092	14,074,092	

(iii) Rreziku i tregut

Rreziku i tregut është rreziku që ndryshimi i çmimeve të tregut: si kursi i këmbimit të valutave, norma e interesit apo çmimi i aksioneve do të ndikojë në të hyrat dhe instrumentet financiare të mbajtura nga kompania. Objektiva e menaxhimit të rrezikut është që të menaxhojë dhe të kontrollojë ekspozimin ndaj rrezikut të tregut brenda parametrave të pranueshëm, dhe duke optimizuar kthimet.

Instrumentet financiare – Vlera e drejtë dhe menaxhimi i riskut (vazhdim)

(iii) Rreziku i tregut (vazhdim)

Rreziku i valutave të huaja

Kompania nuk është e ekspozuar ndaj rrezikut të valutave të huaja pasi që shumica e fondeve pranohen dhe shpenzohen në euro. Kompania nuk përdor instrumente derivative për të shmangur ekspozimin e saj ndaj rrezikut të kursit të këmbimit të huaj.

Rreziku i normës së interesit

Të ardhurat e kompanisë dhe flukset e mjeteve monetare operative janë në thelb të pavarura nga ndryshimet në normat e interesit të tregut. Instrumentet financiare të kompanisë që bartin interes janë kreditë. Instrumentet në posedim të kompanisë janë me norma fikse të interesit andaj kompania nuk është e ekspozuar ndaj rrezikut të normës së interesit.

Ngjarjet pas datës raportuese

Nuk ka ngjarje të rëndësishme pas datës së raportimit që mund të kërkojnë rregullim ose shpallje në pasqyrat e veçanta financiare.

ADOPTIMI I STANDARDEVE NDËRKOMBËTARE TË REJA DHE ATYRE TË RISHIKUARA PËR RAPORTIM FINANCIAR

Standardet dhe interpretimet në fuqi në periudhën e raportuar

Ndryshimet e mëposhtme të standardeve ekzistuese të publikuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe interpretimet e publikuara nga Komiteti i Interpretimeve të Raportimeve Financiare Ndërkombëtare janë në fuqi për periudhën raportuese (efektiv për periudha vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2021):

- Ndryshimet në fazën e dytë të reformës në Librin e Regjistrimeve të Investimeve (IBOR)
Më 27 Gusht 2020, BSNK lëshoi 'Reformën e Referencës së Normës së Interesit - Faza 2 (Ndryshimet në SNRF 9, SNK 39, SNRF 7, SNRF 4 dhe SNRF 16) me ndryshime që adresojnë çështje që mund të ndikojnë në raportimin financiar pas reformës se një pike referimi të normës së interesit, duke përfshirë zëvendësimin e saj me pike referimi të normës alternative. Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 Janar 2021.
- Ndryshimet në SNRF 4 Kontratat e Sigurimit - një përjashtim i përkohshëm opsional nga zbatimi i SNRF 9 për njësitë ekonomike veprimtaria mbizotëruese e të cilave është lëshimi i kontratave brenda objektit të SNRF 4.
- Ndryshimet në SNRF 16
Më 31 Mars 2021, BSNK publikoi 'Koncesionet e Qirasë të Lidhura me Covid-19 përtej 30 Qershorit 2021 (Amendamenti i SNRF 16)' që zgjat, për një vit, ndryshimi i Majit 2020 që u ofron qiramarrësve një përjashtim nga vlerësimi nëse një koncesion i qirasë i lidhur me Covid-19 është një modifikim i qirasë. Amendamenti është efektiv për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë më ose pas datës 1 Prill 2021.

Standardet dhe interpretimet në fjalë nuk janë ende efektive

Në datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare të veçanta standardet, përmirësimet dhe interpretimet e mëposhtme ishin publikuar por akoma në fuqi.

- Cikli vjetor i përmirësimeve 2018-2020
Më 14 Maj 2020, BSNK lëshoi 'Përmirësimet Vjetore të Standardeve të SNRF 2018-2020'. Deklarata përmban ndryshime në katër Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) SNRF 1, SNRF 9, SNRF 16 dhe

KRU Hidrodrini Sh.A.

Shënime në pasqyrat financiare për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024
(Shumat në Euro)

SNK 41 si rezultat i projektit vjetor të BSNK-së për përmirësime. Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2022.

Standardi Ndryshimet në standard

SNRF 1 - Adoptimi për herë të parë i SNRF-ve Filial si adoptues për herë të parë dhe përjashtimi vullnetar në lidhje me dallimet kumulative të përkthimit

SNRF 9 - Instrumentet Financiare Tarifat në testin "10 për qind" për çregjistrimin e detyrimeve financiare.

Shembuj ilustrues të SNRF 16 - Qiratë Stimujt e qirasë

SNK 41 - Agrikultura Tatimi në matjen e vlerës së drejtë

- Ndryshimet në SNK 16 në lidhje me të ardhurat para përdorimit të synuar

Më 14 Maj 2020, BSNK lëshoi 'Pronë, Impiant dhe Pajisje - Të ardhura para përdorimit të synuar (Ndryshime në SNK 16)' në lidhje me të ardhurat nga shitja e artikujve të prodhuar ndërsa sillte një aktiv në vendin dhe gjendjen e nevojshme që ai të jetë i aftë të veprojë në mënyrën e synuar nga menaxhmenti. Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2022.

- Ndryshimet në SNK 37 në lidhje me kontratat me kushte rënduese (Onerous Contracts)

Më 14 Maj 2020, BSNK lëshoi 'Kontratat me kushte rënduese - Kostoja e Përmbushjes së Kontratës (Ndryshime në SNK 37)' duke ndryshuar standardin në lidhje me kostot që një kompani duhet të përfshijë si koston e përmbushjes së një kontrate kur vlerëson nëse një kontratë është me kushte rënduese. Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë më ose pas 1 janarit 2022.

- Ndryshimet në SNRF 3 që azhurnojnë një referencë në Kornizën Konceptuale

Më 14 Maj 2020, BSNK lëshoi 'Referencën në Kuadrin Konceptual (Ndryshimet në SNRF 3)' me ndryshimet në SNRF 3 'Kombinimet e Biznesit' që azhurnojnë një referencë të vjetëruar në SNRF 3 pa ndryshuar ndjeshëm kërkesat e tij. Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2022.

- Ndryshimet në SNK 1 Klasifikimin e Detyrimeve si afatshkurta ose afatgjata

Më 23 Janar 2020, BSNK lëshoi 'Klasifikimin e Detyrimeve si afatshkurta ose afatgjata (ndryshimet në SNK 1)' duke siguruar një qasje më të përgjithshme për klasifikimin e detyrimeve sipas SNK 1 bazuar në marrëveshjet kontraktuale në vend në datën e raportimit. Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë më ose pas 1 janarit 2022, megjithatë, data e tyre efektive është shtyer në 1 janar 2023.

- Ndryshimet në SNRF 17 Kontratat e Sigurimit

Më 25 Qershor 2020, BSNK lëshoi 'Ndryshime në SNRF 17' për të adresuar shqetësimet dhe sfidat e zbatimit që u identifikuan pasi SNRF 17 'Kontratat e Sigurimit' u publikua në 2017. Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2023.

- Ndryshimet në SNK 1 dhe Deklarata e Praktikës së SNRF 2

Më 12 Shkurt 2021, BSNK publikoi "Shpalosja e Politikave Kontabël" me ndryshime që synojnë të ndihmojnë përgatitësit të vendosin se cilat politika kontabël duhet të shpalosin në pasqyrat e tyre financiare. Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 Janar 2023.

- Ndryshime në SNK 8 - Vlerësimet Kontabël

Më 12 Shkurt 2021, BSNK publikoi 'Përkufizimin e Vlerësimeve Kontabël' për të ndihmuar njësitë ekonomike të bëjnë dallimin midis politikave kontabël dhe vlerësimeve kontabël. Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 Janar 2023.

- Ndryshimet në SNK 12 – Tatimi i Shtyrë

Më 7 Maj 2021, BSNK publikoi 'Tatimi i Shtyrë në lidhje me Asetet dhe Detyrimet që rrjedhin nga Një Transaksion i Vetëm' që sqaron se si kompanitë llogarisin tatimin e shtyrë për transaksione të tilla si qiratë dhe detyrimet e nxjerrjes jashtë përdorimit. Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 Janar 2023.